

BULETINI INFORMATIV

Gjatë muajit korrik, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar ushtrimin e përgjegjësi të tij ligjore për rregullimin, monitorimin dhe zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në kuadër të veprimtarisë së Bordit dhe administratës së ERE-së janë ndërmarrë vendimmarrje dhe aktivitete të rëndësishme që lidhen me licencimin e operatorëve, mbikëqyrjen e tregut, përmirësimin e kuadrit rregullator, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe rritjen e transparencës për publikun.

Në këtë numër të buletinit mujor informativ janë përmbledhur zhvillimet më të rëndësishme të muajit korrik, duke përfshirë procedurat e licencimit dhe ndryshimet në licenca, publikimet zyrtare, të dhënat mbi ecurinë e tregut të energjisë elektrike, çmimet e shitjes së energjisë, si edhe aktet dhe dokumentet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik.

Në përmbushje të misionit të tij institucional, ERE mbetet e përkushtuar në garantimin e një kuadri rregullator të qëndrueshëm, transparent dhe të besueshëm, duke mbështetur zhvillimin e një tregu energjetik konkurrues, të sigurt dhe në përputhje me standardet evropiane.

Për më shumë informacion mbi vendimet e Bordit, aktet rregullatore dhe aktivitetet e institucionit, vizitoni faqen zyrtare të ERE-së: www.ere.gov.al

LICENSIME

Gjatë muajit korrik 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar procedurat administrative për licencimin e subjekteve të reja dhe për ndryshimin, rinovimin, transferimin e licencave ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Procedurat e nisura përfshijnë shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH)” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, me kapacitete të instaluar përkatësisht 50 MW dhe 60 MW, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

Gjithashtu, ERE ka filluar procedurën për licencimin e KESH sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.25 MW, me vendndodhje në Digën e Zadejës, HEC Vau i Dejës, Qarku Shkodër. Projekti parashikon zhvillimin e një kapaciteti të ri fotovoltaik në infrastrukturën ekzistuese të HEC-it Vau i Dejës, duke përfaqësuar një iniciativë që ndërthur prodhimin hidroenergjetik me prodhimin nga burimet diellore. Zhvillimi i këtij projekti



synon shfrytëzimin më efikas të infrastrukturës ekzistuese dhe diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Po gjatë kësaj periudhe, ERE ka nisur procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike nga një impiant fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër. Projekti përfshin edhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit. Nëpërmjet kontratës datë 10.02.2026, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë shoqërisë i është dhënë e drejta për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, operimin, shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e centralit, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara.

Projekti është miratuar me Vendimin nr. 22, datë 21.01.2026, të Këshillit të Ministrave.

Krahas kësaj, shoqëria “GERTI” sh.p.k. ka aplikuar edhe për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat pesëvjeçar.

Në vijim, pas përfundimit të shqyrtimit administrativ dhe teknik të aplikimeve dhe verifikimit të plotësisë së dokumentacionit, kërkesa do të vijojë të trajtohet sipas procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore në fuqi objekt i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s.

BULETINI INFORMATIV

Vendime fillim procedure rinovim licence

Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurës për rinovimin e licencave të shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. në veprimtaritë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, për një afat pesëvjeçar.

Vendime fillim procedure modifikim licence

Gjithashtu, Bordi i ERE-s ka filluar procedurat edhe për modifikimin e licencës së shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me qëllim rritjen e kapacitetit të instaluar nga 50 MW në 100 MW. Rezulton se, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 19.06.2026, është miratuar ndryshimi i kapacitetit të instaluar të impiantit gjenerues të energjisë elektrike “Blue 2”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga 50 MW në 100 MW. Projekti, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, do të zhvillohet nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., së bashku me veprat ndihmëse përkatëse.

Për këto aplikime, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka publikuar njoftimet përkatëse në median e shkruar, në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, duke garantuar transparencën e procesit dhe mundësinë e paraqitjes së objeksioneve të mundshme përpara vendimmarrjes përfundimtare.



Vendime zgjatje afati vendimmarrjeje

Gjatë muajit korrik 2026, Bordi i ERE-s ka vendosur zgjatjen me 30 ditë të afatit të vendimmarrjes për disa kërkesa për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.



Këto procedura lidhen me shoqërinë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier; shoqërinë “DOMA GROUP” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Vinjolli 1”, me vendndodhje në Përroin e Varroshit, Manazdresë dhe Lajthit, Degë të Përroit Zall i Madh, Bashkia Mat, Qarku Dibër; si dhe shoqërinë “GLOBAL INTERPRISE GROUP” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 MW, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e lumit Mat, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Përveç sa më sipër, Bordi i ERE-s vendosi heqjen e pezullimit dhe zgjatjen me 30 ditë të afatit të vendimmarrjes për shoqërinë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Bushtica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, Qarku Elbasan, pas depozitimit të dokumentacionit plotësues në kuadër të procedurës së licencimit

Zgjatja e afatit është vendosur me qëllim përfundimin e shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, kryerjen e verifikimeve të nevojshme teknike, ligjore dhe administrative, si dhe vlerësimin e të gjitha elementeve që lidhen me përmbushjen e kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi. Gjatë kësaj periudhe shtesë, ERE do të vijojë analizën e dokumentacionit të depozituar, do të vlerësojë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të licencimit për secilin aplikim dhe, pas përfundimit të shqyrtimit, çështjet do t'i paraqiten Bordit të ERE-s për marrjen e vendimit përfundimtar.

BULETINI INFORMATIV

Vendime pezullimi

Në kuadër të administrimit të procedurave në vijim, Bordi i ERE-s ka vendosur pezullimin e afatit të vendimmarrjes për transferimin e licencës së dhënë shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., deri në depozitimin e qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Procedura lidhet me faktin se shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të miratimit, ka nënshkruar me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë kontratën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e këtij hidrocentrali.

Gjithashtu, ERE ka vendosur të pezullojë afatin e vendimmarrjes për kërkesat e shoqërive “ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k., “ERSEKA SOLAR PARK 2” sh.p.k., “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” sh.p.k., “IDI 2005” sh.p.k., “POWER ENERGY” sh.p.k., “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. dhe “GREENSOL” sh.p.k., lidhur me modifikimin e licencave të prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike respektive, për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencave përkatëse, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centraleve. Pezullimi i afatit të vendimmarrjes për këto kërkesa do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në përfundim të këtij afati, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimmarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

Po ashtu, ERE ka licencuar shoqërinë “NEXORA ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat pesëvjeçar.



Shoqëri të licensuara gjatë muajit Korrik

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Bordi i ERE-s ka vendosur të licencojë disa shoqëri në sektorin e energjisë elektrike. Shoqëria “DOMA GROUP” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Vinjolli 1”, me kapacitet të instaluar 1.840 MW, me vendndodhje në Përroin e Varroshit, Manazdresë dhe Lajthit, Degë të Përroit Zall i Madh, Bashkia Mat, Qarku Dibër, për një periudhë 30-vjeçare. Ky impiant pritet të vihet në operim brenda datës 30.04.2027.

Gjithashtu, është licencuar shoqëria “GREENSOL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 41.29 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, për një afat 25-vjeçar. Ky impiant pritet të vihet në operim brenda datës 19.12.2028.



Vendime transferimi licence

Në kuadër të riorganizimit të veprimtarive të operatorëve në treg, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe licencës së furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k., paraqitur në kuadër të strukturimit të veprimtarive të shoqërive, me qëllim ndarjen dhe organizimin më efikas të aktiviteteve përkatës.

BULETINI INFORMATIV

Vendime të ndryshme rishikim kushtesh

Gjatë muajit korrik, në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit përkatës të licencimit, Bordi i ERE-s ka vendosur të ndryshojë vendimin e licencimit të shoqërisë “DION ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW. Këto ndryshime pasqyrojnë përmbushjen e kushtit të vendosur në vendimin e licencimit, lidhur me depozitimin brenda afatit të dokumentacionit përkatës të testimit të



GARANCITË E ORIGJINËS

Në mbledhjen e datës 28.07.2027, bordi i EREs shqyrtoi raportin periodik mbi Garancitë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, për periudhën maj-qershor 2026. Raporti evidentoi funksionimin normal të regjistrimit elektronik të Garancive të Origjinës, miratimin e aplikimeve të Nova Solar System sh.p.k. dhe KESH sh.a., si dhe realizimin e 7 transferimeve të Garancive të Origjinës ndërmjet subjekteve të regjistruara, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e këtij tregu në Shqipëri. Gjatë periudhës së raportimit nuk u refuzua asnjë aplikim, nuk u pezullua asnjë procedurë dhe regjistri funksionoi pa probleme teknike apo operative. Në datën e raportimit, regjistri elektronik përmban: 8 llogari aktive të subjekteve dhe llogarinë e ERE-së si autoritet lëshues; 4 impiante prodhimi të regjistruara; 481,182 MWh Garanci Origjine të lëshuara, nga të cilat 456,020 MWh aktive, 163,102 MWh të transferuara dhe 25,162 MWh të skaduar.

AUTORIZIME PËR GARANCI FINANCIARE

Gjatë muajit korrik 2026, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesat për marrje autorizimi si më poshtë vijon:

Transferim asetesh (fillim procedure)

Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të asetëve të paluajtshme, si garanci për shlyerjen e detyrimeve ndaj Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Në kuadër të kësaj procedure, ERE do të kërkojë informacion dhe dokumentacion shtesë nga subjekti aplikues, si dhe do të kryejë vlerësimin ligjor dhe financiar të marrëveshjes për të siguruar përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi.

Ndryshim ortaku

Bordi i ERE-s, ka vendosur të japë autorizimin për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “D I E Z E L A” sh.p.k. Ndryshimi lidhet me transferimin e kuotave të kapitalit të shoqërisë “D I E Z E L A” sh.p.k., ku pas shitjes së kuotës së kapitalit, struktura e ortakërisë ndryshon dhe po ashtu ortaku kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë.

REMIT

Gjate muajit korrik 2026, në përputhje me “Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (Regjistri REMIT). Për vitin 2026, numri total i shoqërive të regjistruara në regjister është 106. Përgjatë muajit korrik janë regjistruar 2 subjekte, respektivisht shoqëritë: “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. dhe “DION ENERGJI” sh.p.k. Ky regjister gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare të ERE-s: remit.ere.gov.al

BULETINI INFORMATIV



TREGU I ENERGJISË

Gjatë muajit qershor 2026, vijoi operimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese nga burimet hidrike dhe fotovoltaike në sistemin elektroenergjetik vendas, ndërsa proceset për zhvillimin dhe integrimin e kapaciteteve të reja vijojnë sipas procedurave dhe afateve përkatëse.

Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për këtë muaj është 359,950 MWh, ose rreth 77% më shumë energji elektrike e prodhuar se muaji qershor i vitit të kaluar. Niveli i liqenit të Fierzës, i cili është bazeni kryesor në Kaskadën e lumit Drin, në fillim të muajit arriti kuotën prej 296.36 mmnd, ndërsa fundi i muajit u mbyll në nivelin 293.05 mmnd. Sikurse evidentuar përgjatë këtij muaji, kemi ulje të nivelit të ujit në liqenin e Fierzës prej rreth 3.31 metër. Prurjet mesatare mujore në këtë liqen rezultuan 92 m³/sek, ndërsa rezerva energjetike për Kaskadën e Drinit në fund të muajit qershor ishte 1339.4 GWh.

Gjatë këtij muaji shoqëria publike “KESH” sh.a. nuk ka pasur shkarkime pa prodhim energjie nga portat e HEC-eve në kaskadë, si dhe nuk ka kryer procedura blerjeje të energjisë elektrike në treg të parregulluar sipas detyrimit për shërbimin publik të vendosur në VKM nr. 456/2022, të ndryshuar.

Gjithashtu, gjatë këtij muaji shoqëria publike “KESH” sh.a. nuk ka pasur teprica për tregtim në tregjet rajonale dhe, si e tillë, nuk janë realizuar procedura për shitje të energjisë elektrike në treg të parregulluar.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin qershor rezultoi 62,675 MWh (dalje), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 308,417 MWh dhe importit të realizuar në sasinë prej 245,743 MWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike gjatë muajit qershor 2026 rezultuan në nivelin 14.54%, ndërsa humbjet në sistemin e transmetimit u regjistruan në vlerën 1.83%. Krahasuar me muajin maj 2026, këta tregues paraqesin një rritje prej 0.6 % për sistemin e shpërndarjes dhe ulje prej 0.16 % për sistemin e transmetimit, duke pasqyruar ndryshimet mujore në ecurinë e treguesve teknikë të rrjeteve të energjisë elektrike.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it u tregtuan gjithsej 202,976.08 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 51,214.66 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 197,164.11 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 91.55 €/MWh, ndërsa në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 5,811.97 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 92.91 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës ishte 48, të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë, ndërsa 34 prej tyre edhe në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë. Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit arriti në 6.

Të dhënat e mësipërme pasqyrojnë veprimtarinë tregtare të zhvilluar gjatë periudhës raportuese në Tregun e Ditës në Avancë dhe në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë, si dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të bursës në këto segmente të tregut.

BULETINI INFORMATIV

ZHVILLIME NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Gjatë muajit korrik, Bordi i ERE shqyrtoi dhe miratoi analizën dhe vlerësimin e raporteve vjetore të Pajtueshmërisë për vitin 2025 të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Transmetimit. Në përfundim të shqyrtimit të raporteve, u lanë detyrat përkatëse për ndjekjen e gjetjeve dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet përkatëse. Analiza e raporteve evidentoi se gjatë vitit 2025 janë ruajtur pavarësia funksionale, organizative dhe operacionale e operatorëve, si dhe janë zbatuar masa për garantimin e trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit, mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe forcimin e transparencës. Zbatimi i Programit të Pajtueshmërisë mbetet një element thelbësor edhe në kuadër të Ligjit nr. 59/2026 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, pasi garanton pavarësinë funksionale të operatorëve, parandalon sjelljet diskriminuese dhe promovon transparencën e konkurrencën e ndershme në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin e ri ligjor dhe acquis të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu gjatë këtij muaji, Bordi i ERE-s shqyrtoi dhe miratoi ndryshimin e vendimit nr. 139, datë 14.04.2023 “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”, lidhur me Kufirin Minimal të Lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë i cili ishte 0 €/MWh dhe u bë -50 €/MWh. Aktualisht, në “ALPEX” sh.a. operojnë kompani vendase dhe të huaja të cilat janë pjesëmarrëse në bursat evropiane të cilat karakterizohen nga pranimi i çmimeve negative si pjesë integrale e formimit të lirë të çmimit klerues në tregjet e energjisë elektrike, ndaj u vlerësua që të ndiqet një qasje graduale drejt përafrimit me këto praktika. Miratimi i ndryshimit të Çmimit Minimal Klerues në -50 Eur/MWh do të krijojë një fleksibilitet të shtuar për aktivizimin e mekanizmit të Ankandit të Dytë në tregun e ditës në avancë për faktin se që prej vitit 2024 e në vijim në këtë treg vijnë urdhërporosi me çmime negativ



BULETINI INFORMATIV



Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e zhvilluar më 13.07.2026, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 188, miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për muajin qershor 2026, në nivelin 12.94 lekë/kWh për klientët e lidhur në tensionin 35 kV. Krahasuar me muajin maj 2026, kur çmimi ishte 14.05 lekë/kWh, vlera e miratuar për qershorin rezulton 1.11 lekë/kWh më e ulët, duke shënuar një rënie mujore prej rreth 7.9%. Për klientët e lidhur në tensionin 35 kV, çmimi i FMF-së përcaktohet mbi baza mujore dhe reflekton dinamikën e kostos së blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së klientëve që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit në tregun e lirë. Në strukturën e këtij çmimi, tarifat e përdorimit të rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti që ndikon në luhatjen e tij është kostoja e energjisë së blerë.

Konkretisht, për muajin qershor 2026, çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike rezultoi 9.20 lekë/kWh, kundrejt 10.28 lekë/kWh në muajin maj. Kjo përfaqëson një ulje prej rreth 10.5%, e cila është reflektuar edhe në çmimin përfundimtar të FMF-së, megjithëse në një masë më të moderuar për shkak të peshës së komponentëve të tjerë të pandryshueshëm në strukturën e çmimit.

Për klientët e lidhur në tensionin 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, sipas vendimit të miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori klientësh sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencën ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Zhvillimi i seancave dëgjimore teknike

Gjatë muajit korrik 2026, ERE zhvilloi dy seanca dëgjimore teknike në kuadër të proceseve rregullatore.

ERE zhvilloi seancës teknike dëgjimore të datës 15.07.2026, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërive OST sh.a., OSHEE Group sh.a. si dhe KESH sh.a. Objekti i kësaj seance konsistonte në shqyrtimin e situatës së krijuar në lidhje me shlyerjen e detyrimeve reciproke ndërmjet palëve OST sh.a., OSHEE Group sh.a. si dhe KESH sh.a. Gjatë diskutimit u trajtuan çështjet përsa i përket evidentimit të plotë të detyrimeve të prapambetura dhe korente ndërmjet shoqërive, ecurinë e tyre me planet e shlyerjes së këtyre detyrimeve me synim sqarimin e gjendjes financiare. Gjithashtu, më datë 22.07.2026 u zhvillua një seancë dëgjimore teknike ndërmjet përfaqësuesve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe shoqërisë OST sh.a. Qëllimi i kësaj seance ishte vijimi i procesit të shqyrtimit të çështjeve që lidhen me komponenten nxitëse dhe të ardhurat e krijuara nga tregu i balancimit. Gjatë diskutimeve u trajtuan analizat dhe informacionet e paraqitura nga shoqëria OST sh.a., me synim sqarimin e mëtejshëm të metodologjisë së aplikuar, vlerësimin e ndikimit të mekanizmit nxitës në funksionimin e tregut të balancimit, si dhe evidentimin e çështjeve teknike që kërkojnë trajtim të mëtejshëm në kuadër të procesit të shqyrtimit nga ERE.

BULETINI INFORMATIV

Vendimarrjet e Bordit të ERE-së gjatë muajit korrik

Gjatë muajit korrik 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) zhvilloi 5 mbledhje vendimmarrëse, të njoftuara publikisht të paktën 24 orë përpara zhvillimit të tyre, në përputhje me parimet e transparencës dhe informimit të publikut. Njoftimet u publikuan në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të institucionit, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara ndjekjen online të mbledhjeve.

Gjatë këtyre mbledhjeve, Bordi miratoi gjithsej 29 vendime, të cilat trajtuan një gamë të gjerë çështjesh rregullatore, ndër to fillimin e procedurave të licencimit, dhënien, transferimin dhe modifikimin e licencave, miratimin e çmimeve dhe tarifave të rregulluara, si dhe akte të tjera rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për të garantuar informimin në kohë të publikut dhe transparencën e procesit vendimmarrës, pas çdo mbledhjeje u publikua një përmbledhje e vendimeve të miratuara në kanalet zyrtare të komunikimit të ERE-së. Ndërkohë, tekstet e plota të vendimeve janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën “Vendime”, si dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Platforma e Krahasimit të Çmimeve (PCT)

Gjatë muajit korrik 2026, në Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT), rezultojnë të regjistruar gjithsej 7 furnizues që ofrojnë furnizimin me energji elektrike për konsumatorët në tregun e lirë, sipas nivelit të tensionit. Çmimet e publikuara në platformë paraqesin alternativat e ofruara nga furnizuesit dhe ndryshojnë në varësi të kategorisë së konsumatorit.

Për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 6 kV, çmimet variojnë nga 16.9 lekë/kWh deri në 18.34 lekë/kWh, ndërsa për stacionet e karikimit të automjeteve elektrike çmimi i ofruar është 22 lekë/kWh.

Për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kV, çmimet variojnë nga 15.8 lekë/kWh deri në 18.34 lekë/kWh, ndërsa për stacionet e karikimit çmimi i ofruar është 22 lekë/kWh.

Për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, çmimet variojnë nga 15.75 lekë/kWh deri në 18.34 lekë/kWh, ndërsa për stacionet e karikimit çmimi i ofruar është 22 lekë/kWh.

Për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, çmimet variojnë nga 15.20 lekë/kWh deri në 15.90 lekë/kWh.

Platforma e Krahasimit të Çmimeve (PCT) synon të rrisë transparencën në tregun e lirë të energjisë elektrike, duke u mundësuar konsumatorëve të krahasojnë ofertat e furnizuesve të licencuar dhe të zgjedhin alternativën që i përshtatet më mirë nevojave të tyre.



Plani i masave të gatishmërisë për garantimin e furnizimit me energji elektrike në zonat bregdetare gjatë sezonit veror qershor-shtator 2026 dhe vlerësimi i masave të raportuara nga OSSH sh.a.

Në kuadër të monitorimit të sigurisë së furnizimit me energji elektrike gjatë sezonit veror 2026, Bordi i ERE-s shqyrtoi Planin e Masave të Gatishmërisë të paraqitur nga OSSH sh.a. për garantimin e furnizimit me energji elektrike në zonat bregdetare, për periudhën qershor-shtator 2026.

Nga vlerësimi i planit rezultoi se OSSH sh.a. ka ndërmarrë një sërë masash teknike dhe organizative për rritjen e gatishmërisë së rrjetit gjatë periudhës me ngarkesë të shtuar, duke përfshirë planifikimin e ndërhyrjeve parandaluese, organizimin e strukturave operacionale dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për menaxhimin e situatave të mundshme. Njëkohësisht, ERE evidentoi nevojën për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur me analiza më të detajuara mbi parashikimin e kërkesës për energji elektrike, kapacitetet e rrjetit, analizën e riskut dhe treguesit e performancës, me qëllim vlerësimin më të plotë të mjaftueshmërisë së masave të planifikuara.

Në zbatim të rolit të saj mbikëqyrës, ERE do të monitorojë zbatimin e planit përmes raportimeve periodike gjatë sezonit veror dhe i kërkoj OSSH sh.a. paraqitjen e informacionit shtesë për të mundësuar një vlerësim të plotë të efektivitetit të masave të ndërmarra.

BULETINI INFORMATIV

Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kontratën Tip “Për shit-blejen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”

Në mbledhjen e datës 24.07.2026, Bordi i ERE-s shqyrtoi dhe miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Kontratën Tip për shit-blejen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2026.

Ndryshimet e miratuara synojnë qartësimin e procedurave të faturimit dhe pagesës, si dhe rregullimin e rasteve të veçanta të shtyrjes së afatit të pagesës, duke kontribuar në zbatimin më të qartë dhe më efektiv të marrëdhënieve kontraktore ndërmjet palëve.

Me vendimin nr. 208, datë 24.07.2026, Bordi i ERE-s ngarkoi shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. të përditësojnë bazën ligjore të kontratës në përputhje me Ligjin nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Përmes këtij vendimi, ERE synon të forcojë sigurinë juridike, transparencën dhe monitorimin e zbatimit të detyrimit të shërbimit publik, duke garantuar një kuadër kontraktor të harmonizuar me legjislacionin në fuqi dhe funksionimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë elektrike.



Raportimi i ERE-së në Kuvendin e Shqipërisë

Gjatë muajit korrik, në faqen zyrtare dhe në rrjetet social e të institucionit u publikuan gjithashtu informacione mbi veprimtarinë institucionale të ERE-së në Kuvendin e Shqipërisë. Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë, z. Petrit Ahmeti, raportoi në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit për veprimtarinë e ERE-së gjatë vitit 2025.

Në këtë kuadër u informua publiku edhe mbi shqyrtimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2025”, në të cilën u vlerësuan rezultatet e institucionit në një sërë drejtimesh kyçe, si ulja e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, promovimi i vetëprodhimit nga burimet fotovoltaike, zhvillimi i tregut të energjisë përmes bursës ALPEX, funksionimi i Platformës së Krahimit të Çmimeve, si dhe miratimi i akteve rregullatore dhe strategjive që kontribuojnë në rritjen e sigurisë energjetike dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Publikimet evidentuan gjithashtu rekomandimet e projektrezolutës për veprimtarinë e ERE-së gjatë vitit 2026, të fokusuara në forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve, përmirësimin e standardeve të cilësisë së shërbimit, avancimin e procesit të liberalizimit të tregut të energjisë, harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian, monitorimin e zhvillimit të bursës ALPEX, si dhe mbështetjen e integritetit të burimeve të rinovueshme dhe vetëprodhuesve në sistemin energjetik.

Përmes këtyre publikimeve, ERE vijoi të zbatojë parimet e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit të hapur me publikun, duke garantuar informim të vazhdueshëm për konsumatorët, operatorët e licencuar, institucionet dhe çdo palë tjetër të interesuar mbi zhvillimet kryesore në sektorin energjetik dhe aktivitetin rregullator të institucionit.



BULETINI INFORMATIV

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit korrik 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vijoi të zhvillojë një komunikim të vazhdueshëm dhe transparent me publikun nëpërmjet publikimeve të rregullta në faqen zyrtare www.ere.gov.al dhe në kanalet zyrtare në Facebook, Instagram dhe LinkedIn. Gjatë këtij muaji, fokusi i komunikimit institucional ishte informimi i publikut mbi zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike, aktivitetin institucional të ERE-së dhe proceset që lidhen me zbatimin e legjislacionit të ri të sektorit.

Një nga publikimet kryesore të muajit ishte hyrja në fuqi e Ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili u botua në Fletoren Zyrtare më 30 qershor 2026. Përmes këtij publikimi, ERE informoi publikun se Shqipëria hyn në një etapë të re të zhvillimit të tregut të energjisë elektrike, duke përafruar më tej kuadrin ligjor me standardet e Bashkimit Evropian. Ligji sjell ndryshime të rëndësishme për funksionimin e tregut, forcimin e konkurrencës dhe transparencës, mbrojtjen e konsumatorëve, zhvillimin e teknologjive të reja, vetëprodhimin, matjen inteligjente dhe integrimin e mëtejshëm të tregut shqiptar me tregun evropian.

Në vijim të këtij zhvillimi, ERE bëri të ditur se do të nisë procesin e hartimit dhe rishikimit të akteve rregullatore të nevojshme për zbatimin e plotë të dispozitave të ligjit të ri. Institucioni ftoi operatorët e sektorit, shoqatat e konsumatorëve, komunitetin e biznesit, institucionet, ekspertët dhe të gjitha palët e interesuara të marrin pjesë aktive në proceset e konsultimit publik, duke garantuar një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

“Gjatë këtij muaji, ERE ka njoftuar operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë për detyrimin e njoftimit dhe regjistrimit pranë ERE-s, në zbatim të nenit 51, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Operatorët që disponojnë impiante depozitimi në zhvillim ose në operim, pa licencë të veçantë për operimin e tyre, duhet të paraqesin njoftimin pranë ERE-s brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”

Në webfaqen e ERE-së gjenden të përditësuara regjistrat elektronikë dhe informacioni institucional, përfshirë:

- * Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- * Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- * Licencime ([kliko këtu](#))
- * Autorizime ([kliko këtu](#))
- * Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- * Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))

Për më shumë informacion:

Ftojme të gjithë qytetarët, operatorët e tregut dhe palët e interesuara të vizitojnë faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë për të aksesuar vendimet e Bordit, aktet rregullatore, dokumentet në konsultim publik, raportet, tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, si dhe të gjitha publikimet më të fundit të institucionit.

Faqja zyrtare: www.ere.gov.al

Ju ftojme gjithashtu të ndiqni ERE në [Instagram](#), [LinkedIn](#), [Facebook](#) për t'u informuar në kohë reale mbi vendimmarrjet e Bordit, procedurat e licencimit, konsultimet publike, aktivitetet institucionale dhe zhvillimet më të rëndësishme në tregun e energjisë.